

KOMUNA E BUJANOCIT
Kryetari i komunës së Bujanocit, Nagip Arifi

Rruga - Karagjorgje Petroviq 115
17520-Bujanoc

Lënda: Njoftim – Rregullore për konsumatorët e rrezikuar nga energjia

I nderuar z.Nagip Arifi.

Ju informojmë se Qeverija e Republikës së Serbisë, në bazë të nenit.10 , të Ligjit energjetik “ (Gazeta zyrtare RS”, nr. 145/14, 95/18 – tjera , ligji dhe 40/21, në tekstin vijues: Ligji bjen rregulloren për konsumatorët e rrezikuar të energjisë (“Gazeta zyrtare e RS “, nr.137/22 në vijim : Rregullorja) e cila ka hyrë në fuqi më 17. Dhjetorë të vitit 2022.

Falë ndihmës buxhetore të pakthyeshme të Bashkimit Evropian për Republikën e Serbisë, për zbatimin e këtij programi në vitin 2023., janë siguruar deri në 4 miliardë dinarë i cili mbulon mbrojtjen rreth 190.000,00 familjeve të konsumatorëve të rrezikuar nga energjia.

Konsumatori i pambrojtur nga energjia është një konsumatorë i kategorisë familjare (një ose shumë anëtarësh), i cili në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj dhe Rregullore mund të fitojë statusin e konsumatorit të dëmtuar dhe rrjedhimisht të drejtën e subvencionimit në pagesë mujore për energjinë elektrike, gas natyrorë ose energji termike , në varësi nga nevojat e kërkuara të amvisërive.

Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar nga energjia, përfshirë edhe familjet që janë shfrytëzues të së drejtës së ndihmës sociale në të holla dhe / ose shtesat për fëmijë, shfrytëzues të shtesave të shtuara për përkujdesjen dhe ndihmën e ndonjë personi tjetër. Personat e kësaj kategorie përfitojnë automatikisht statusin, vetëm nëse paraqesin kërkesë pranë autoritetit përgjegjës për qështjet e mbrojtjes sociale në njësinë e vetëqeverisjes lokale, i cili me Aktvendim vendos për plotësimin e kushteve që amvisëritë të përfitojnë statusin e një familjeje të rrezikuar energjik.

Në këtë mënyrë, dëshiroj të ju rikujtoj rëndësinë e zbatimit në kohë të Rregullores për konsumatorët e rrezikuar nga energjia dhe të theksoj se vetëqeverisjet lokale duhet të rrisin disponueshmërinë e kësaj të drejte për familjet e rrezikuara, duke informuar më mirë qytetarët e tyre për gjendjen që ndikon në rritjen e numrit të familjeve të mbrojtura, të cilat, në përputhje me Rregulloren do të ushtrojnë të drejtën e zvogëlimit së faturave.

Është e pamundur të zbatohet programi i mbrojtjes pa përfshirjen e njërive vetëqeverisëse, organi i të cilave është përgjegjës për qështjet e mbrojtjes sociale, të përcaktuara nga plotësimi i kushteve që familja të fitojë statusin e konsumatorit të rrezikuar nga energjia. Të dhënat nga Aktvendimi i statusit të përfituar, vetëqeverisjet lokale ia dërgojnë furnizuesve të energjisë elektrike, të gasit natyrorë, përkatësisht energjisë termike, të cilët këtyre blerësve u zvogëlojnë faturat mujore.

Kthimi i mjeteve në bazë të zvogëlimit të faturave furnizuesit e realizojnë nga buxheti i Republikës së Serbisë, në bazë të kërkesës së paraqitur dhe dokumentacionit të Ministrisë së minierës dhe energjetikës.

Konsumatori i rrezikuar nga energjia nuk është risi në legjislacionin e Serbisë, programi është zbatuar që nga viti 2015, por me ndryshimin e kushteve për marrjen e statusit dhe miratimin e Rregullores së re, gjegjësisht në rritjen e shkallës së mbrojtjes për familjarët, të cilët për kushtet e tanishme të krizës energjetike janë më të kërcënuara nga rritja e qmimit të energjisë elektrike, e cila është rritur ndjeshëm. Gjithashtu, për mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar nga energjia buxheti për vitin 2023., parashikoi tri herë më shumë mjete se vitet e kaluara.

Vetëm me veprim të përbashkët do ta mbrojmë standardin e familjeve me të ardhura minimale dhe në këtë mënyrë do të kontribuojmë në kënaqësinë më të madhe të qytetarëve.

E përktheu :
Vlora Islami.

